



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
AGJENCIA SHTETËRORE PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
DRZAVNA AGENCIJA ZA ZASTITU LICHNIH PODATAKA  
NATIONAL AGENCY FOR PROTECTION OF PERSONAL DATA  
ZYRA E ARKIVIT-KANCELARIJA ARKIVË-Archive Office

Nr. prot. 01/168  
Ditë. 01.10.2012  
Nr. Pro. 09  
Ditë. 01.10.2012  
Pristina/A



**Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale  
Drzavna Agencija za Zastitu Licnih Podataka  
National Agency for Protection of Personal Data**

Nr. prot. 25/2012  
Datë: 01.10.2012

Në mbështetje të nenit 49 (parografi 1, nënparografi 1.5.) të Ligjit Nr.03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 70/31 maj 2010) Mbikëqyrësi Shtetëror merr këtë:

**V E N D I M**

1. Këshillohet Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë që të marrë vendim për instalimin e sistemit të vëzhgimit me kamerë.
2. Të vendosë njoftimin për instalimin e sistemit të vëzhgimit.
3. MASHT, në afat prej 15 ditësh të njoftojë Agjencinë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e pranimit të këtij vendimi.

**Arsyetim**

Në bazë të nenit 46, nenit 47 dhe nenit 48 (parografi 1. 1.4.) të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në tekstinë metejmë LMDHP), më datë 30.07.2012, Agjencia ka realizuar kontolle sipas detyrës zyrtare në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe ka konstatuar se vendosja e sistemit të vëzhgimit me kamerë nuk përbushë rregullativën ligjore.

Pas kontrollit është përpiluar procesverbal me nr.05/2012, i cili është nënshkruar nga zyrtari përgjegjës dhe të njëjtit i është dorëzuar një kopje.

Në bazë të kontrollit të bërë, në procesverbal është konstatuar kjo gjendje:

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka të instaluar sistemin e vëzhgimit me kamerë, por nuk ka vendim të shkruar për instalimin e sistemit të vëzhgimit. Në nenin 62 (parografi 1) thuhet personat në sektorin publik dhe privat mund të instalojnë

sistemet e vëzhgimit me kamerë për vëzhgimin e ndërtesave të tyre, nëse konsiderohet e nevojshme për sigurinë e njerëzve dhe sigurimin e pasurisë. Vëzhgimi me kamerë, në veçanti, mund të jetë i nevojshëm për të vëzhguar hyrjet e ndërtesave ose ku për shkak të natyrës së punës së tyre ekziston kërcënëm potencial ndaj të punësuarve.

Në nenin 62 (paragrafi 2 dhe 3) të LMDHP thuhet që vendimet e nevojshme merren nga nëpunësi kompetent, drejtori ose ndonjë person tjetër i autorizuar nga sektori publik ose privat. Vendimi duhet të përmbarjë arsyet për vendosjen e sistemeve të vëzhgimit me kamerë.

MASHT nuk ka të vendsur njoftimin per instalimin e sistemet e vëzhgimit me kamerë. Në nenin 61 (paragrafi 2) të LMDHP thuhet se personat në sektorin publik ose privat që kanë për qëllim të instalojnë sistemet e vëzhgimit me kamerë duhet të vendsin njoftimin për këtë. Njoftimi i tillë duhet të jetë i dukshëm dhe të bëhet publik në mënyrë që t'i mundësojë subjekteve të të dhënave që pa vështirësi të njoftohen me masat, më së voni kur të fillojë vëzhgimi me kamerë.


Në nenin 64 (paragrafi 4) të LMDHP thuhet se para instalimit të sistemit të vëzhgimit me kamerë, punëdhënësi duhet t'i informojë me shkrim subjektet e të dhënave për të drejtat e tyre dhe arsyet për vëzhgim. Hapësirat e mbikëqyrura duhet të shënohen nga punëdhënësit përmes shenjave të përshtatshme.

Sic është përshkruar në arsyetimin e ketij vendimi, bazuar në nenin 49 (paragrafi 1, nënparagrafi 1.5.) të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënavë Personale, mbikëqyresi kryesor shtetëror ka marrë vendimin e paraqitur në dispozitiv.

#### Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa, por mund të hapet konflikt administrativ në Gjykatën kompetente në afatin prej 30 ditësh.

Ruzhdri Jashari



Mbikëqyrës Kryesor Shtetëror



#### Vendimi i dërgohet:

- MASHT
- Anëtarëve të Këshillit të Agjencisë
- Arkivit të Agjencisë

Adresa: Pejton Rr. Pashko Vasa Nr. 4, 10000 Prishtinë – Kosovë